



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 73

Tiranë – E hënë, 17 maj 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 11.5.2021	Për heqjen nga fondi kullësor dhe ndryshimin e statusit nga kategoria e resursit “kullotë” në “tokë urbane” truall, të pasurisë me numër 28/3, dhe miratimin e ndryshimit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane” truall, të pasurisë me numër 26, zona kadastrale 2936, Bashkia Tepelenë.....
	8119
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 263, datë 12.5.2021	Për miratimin e rregullores për klasifikimin e informacionit “Sekret shtetëror”.....
	8127
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 12.5.2021	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Përmet, të Njesisë Administrative Frashër, të disa pronave me vendndodhje në zonën kadastrale 2822.....
	8133
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 12.5.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 58, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Gramsh, të pronës nr. 334, me emërtim ‘Ish-Reperti ushtarak nr. 9920, Grup Depo’, me vendndodhje ‘Përroi i Çekrezit’, Gramsh, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....
	8142
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 266, datë 12.5.2021	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Berat, për Njësine Administrative Berat, të pasurisë me nr. 24/220, me vendndodhje në zonën kadastrale 8502, dhe për një shtesë në vendimin nr. 834, datë 21.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat, të qarkut të Beratit”, të ndryshuar.....
	8142
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 12.5.2021	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri i ofruesve të shërbimit inovativ dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara”.....
	8145

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 12.5.2021	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Sulltanatit të Omanit, mbi përjashtimin e ndërsjellë të vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, speciale dhe të shërbimit.....	8147
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 12.5.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 94, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat për armët në rastet e deklarimit të vdekjes, deklarimit të mbylljes ligjore të aktivitetit, Për qëllime studimore, të humbjes së armës, vjedhjes së saj apo dokumentit/autorizimit”.....	8149
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 270, datë 12.5.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 96, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të deklarimit, ruajtjes, regjistrimit dhe paaftësimi për armët e koleksionit”.....	8150
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 12.5.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 275, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve’”.....	8151
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 272, datë 12.5.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 348, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorisë “B” dhe “C” në territorin e Republikës së Shqipërisë”.....	8153
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 273, datë 12.5.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1088, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit dhe publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente dhe nga subjektet e detyruara”.....	8154
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 12.5.2021	Për përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore.....	8155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 275, datë 12.5.2021	Për miratimin e tarifave për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike të nevojshme për kontrollin e kripës së jodizuar..	8156
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 12.5.2021	Për dhënien e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special”, aplikuesit “Marina Al” sh.p.k.....	8156
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 278, datë 12.5.2021	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për mbështetjen e turizmit shqiptar për promovimin në tregjet ndërkombëtare post COVID-19.....	8157
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 279, datë 12.5.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak, dhe caktimin e Bashkisë Shijak si njësi zbatuese.....	8157
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 12.5.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit, në Bashkinë Mirditë.....	8158
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 12.5.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit dhe të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë.....	8158

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 282, datë 12.5.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 1047, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare ‘At Zef Pëllumbi’, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë”.....	8159
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 12.5.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në bashkitë Kamzë dhe Kavajë dhe caktimin e tyre si njësi zbatuese”.....	8159

**VENDIM****Nr. 262, datë 11.5.2021**

**PËR HEQJEN NGA FONDI KULLOSOR
DHE NDRYSHIMIN E STATUSIT NGA
KATEGORIA E RESURSIT “KULLOTË”
NË “TOKË URBANE” TRUALL, TË
PASURISË ME NUMËR 28/3, DHE
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NGA
KATEGORIA E RESURSIT “TOKË
BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”
TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 26,
ZONA KADASTRALE 2936,
BASHKIA TEPELENË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, pika 1, shkronja “b”, 10, pika 6, dhe 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga fondi kullor të pasurisë me nr. 28/3, zona kadastrale 2936, Bashkia Tepelenë, me sipërfaqe prej 5.6 ha, pjesë e ekonomisë kullorë “Qendër Tepelenë”, që do të përdoret nga shoqëria “Zagroturizëm” sh.p.k., për resort agroturistik në Peshtan, Bashkia Tepelenë, dhe çregjistrimin nga Regjistri i Kadastrës së Pyjeve Kullotave.

2. Ndryshimin e kategorisë së resursit “kullotë” në “truall”, të pasurisë me numër 28/3, dhe nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “truall”, të pasurisë me numër 26, zona kadastrale 2936,

Bashkia Tepelenë, sipas certifikatave të pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Vlerat përkatëse të produkteve kullorë, në sipërfaqen, objekt ndërtimi, të pasurisë nr. 28/3, paguhen nga shoqëria “Zagroturizëm” sh.p.k., në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Tepelenë, në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Zagroturizëm” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen kullorë, sipas kushteve të VNM-së paraprake dhe të legjislacionit në fuqi për fondin kullor.

5. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Gjirokastrë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “kullotë” në “truall”, të pasurisë me numër 28/3, zona kadastrale 2936, dhe nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “truall”, të pasurisë me numër 26, zona kadastrale 2936, Bashkia Tepelenë.

6. Drejtoria Rajonale e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tepelenë të bëjë ndryshimin e llojit të pasurisë në certifikatën e pasurisë, sipas të dhënave për pasurinë e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë dhe Drejtoria Rajonale e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2936002115

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2936, Lloji i Pasurisë: ARE, Nr. i Pasurisë: 26, Sipërfaqja Totale 18000 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-137 (20-D), Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia TEPELENE, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare _____ Leke (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT 00000SHTET, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia TEPELENE, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. LN TETOR 9, Datë: 30/07/1997

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

[Stamp]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETËRËRE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00000067	19/10/2018		ME URDHER TE REGJISTRUESI T KALON NE PERDORIM TE BASHKISE TEPELENE			0		
00000134	03/09/2019		NE BAZE TE KONTRATES SE QERASE NR 935 REP 490 KOL DT 24.07.2019 PASURIA I JEPET ME QERA "Z AGROTURIZEM " SH.PK KONTRATE QERAJE			0		

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: _____

DREJTORI
Pëllumb Milori

Pëllumb
Milori

Digitally signed by:

Pëllumb Milori

Date: 2021.03.26

12:10:39 +02'00'

Data e lëshimit 26/03/2021



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tepelene
Date: 2021/03/26 12:10:23 +02'00"
K493225290202103261210T664ASHK


*Shënim : Ky dokument është generuar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ZONA KADASTRALE <u>2936</u>	KODI UNIK <u>2936002115</u>
NUMRI I PASURISË <u>26</u>	INDEKSI I HARTËS <u>K-34-137 (20-D)</u>

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE




SH 1 : 2500

DREJTORI
Pëllumb Milori

Data e Lëshimit 26.03.2021



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vëlosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtorja)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

QËRAJE

PËRFITUESI I SË DREJTËS

(qeramarës, enfiteozëmarrës, kreditor hipotekor etj)

Emri(emër, atësi dhe mbiemër)/ emri i personit juridik	Nr. Personal ID/NIPT
Z AGROTURIZËM	L818290010

Numri i pasurisë	28/3		
Kodi Unik i Pasurisë	2936003190		
Zona Kadastrale	2936		
Lloji i Pasurisë	Kullotë		
Sipërfaqja e Pasurisë	51490 m ²		
Sipërfaqja, ose pjesa takuese e pasurisë, që është objekt i të drejtës reale			
Afati i të drejtës	10 Vjet		
Adresa e pasurisë	Peshtan,Tepelenë		
Pronari/Bashkëpronarët (qeradhënës, enfiteozësdhënës, etj)	Emër, atësi, mbiemër, ose emri i personit juridik	Nr. Personal ID/NIPT	Pjesa (-/-)
BASHKIA TEPELENË	BASHKIA TEPELENË	K493225290	1/1

DREJTORI

Pellumb

Digitally signed by
Pellumb Milori
Date: 2021.03.24
12:26:21 +02'00'

Pëllumb MILORI

Milori

Data e lëshimit 24/03//2021


Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tepelenë
Date: 2021/03/24 12:29:29 +02'00'
K4932252902021032412292174014Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ZONA KADASTRALE <u>2936</u>	KODI UNIK <u>2936003190</u>
NUMRI I PASURISË <u>28/3</u>	INDEKSI I HARTËS <u>K-34-137 (20-D)</u>

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1 : 2500

DREJTORI **Pellumb**
Pëllumb Milori **Milori**

Digitally signed by Pellumb Milori
Date: 2021.03.24 12:26:21 +02'00'

Data e Lëshimit 24.03.2021



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tepelenë
Date: 2021/03/24 12:29:01 +02'00'
K4932252902021032412285406014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria)

SHPIEGUES
☐ PARCELA
☒ NDËRTESA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2936003190
(Nga 2936003165, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2936, Lloji i Pasurisë: KULLOTE, Nr. i Pasurisë: 28/3, Sipërfaqja Totale 51490 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-137 (20-D), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia TEPELENE, Rruga PESHTAN, Ndërtesa Nr. ____, SH/K ____,
Apartamenti Nr. ____
Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 539, Dt. 19/03/2021), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA TEPELENE, Nr. Identifikimi/NIPT K493225290, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i
Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia TEPELENE, Rruga ISH KOMITETI EKZEKUTIV, Ndërtesa Nr. ____,
SH/K ____, Apartamenti Nr. ____
Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr.
539, Datë: 19/03/2021
Regjistruar: Nr. 00146, Datë: 19/03/2021

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____, me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____, Nr. ____, Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. ____, Datë: ____

2.000.000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETËTËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00146	19/03/2021	Qera/Nënqera	Kontratë qeraje/nënqeraje	1318 REP 603 KOL DAT E 19.11.2020 503/3 PRO T	19/03/2021	10 vite	ZAGROTURIZEM	L818290010

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: _____

DREJTORI
Pëllumb Milori

Digitally signed by:
Pëllumb Milori
Date: 2021.03.24
12:27:48 +02'00'

Data e lëshimit 24/03/2021



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tepelenë
Date: 2021.03.24 12:27:07 +02'00'
K49322529Q02021032412270089ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)



Lidhja nr. 1

Nr. rend.	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja në m ²	Sipërfaqja që përdoret për zhvillim m ²	Sipërfaqja ndërtimore m ²	Emërtimi i strukturës
1	Gjirokastrë	Tepelenë	2936	Peshtan	28/3	51490	51490	14665.3	Resort Agroturistik
2	Gjirokastrë	Tepelenë	2936	Peshtan	26	18000	18000	2145.2	Resort Agroturistik

VENDIM
Nr. 263, datë 12.5.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
KLASIFIKIMIN E INFORMACIONIT
“SEKRET SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 31, të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për klasifikimin e informacionit “Sekret shtetëror”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 123, datë 15.3.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE
PËR KLASIFIKIMIN E INFORMACIONIT
“SEKRET SHTETËROR”

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Dispozitat e përcaktuara në këtë rregullore kanë për qëllim disiplinimin, mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe përcaktimin e rregullave për ministritë dhe institucionet

shtetërore, të cilat trajtojnë informacion të klasifikuar.

2. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave që duhet të zbatohen ministritë dhe institucionet shtetërore për klasifikimin e informacionit “Sekret shtetëror”.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar nga ministritë dhe institucionet shtetërore, të cilat prodhojnë informacione që lidhen me sigurimin kombëtar dhe që duhet të klasifikohen “Sekret shtetëror”.

Neni 3

Përkufizime

1. “Klasifikim” është procesi përmes të cilit informacionit i përcaktohet niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së këtij klasifikimi, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

2. “Sekret shtetëror” do të thotë informacioni i klasifikuar sipas ligjit, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikojë sigurimin kombëtar.

3. “Informacion i klasifikuar” është çdo dokument a material, pavarësisht nga forma, natyra ose mënyra e transmetimit të tij, i përgatitur ose që përgatitet, për të cilin është vendosur një nivel i caktuar i klasifikimit në interes të sigurimit kombëtar dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, që kërkon mbrojtje ndaj çdo shkeljeje, shkatërrimi, përvetësimi, përhapjeje, humbjeje ose aksesit nga ndonjë individ i paautorizuar ose çdo lloj tjetër komprometimi sigurie.

4. “Materiali i klasifikuar” përfshin dokumentet, makineritë, pajisjet, armatimet dhe komponentët e tyre të prodhuara ose në proces prodhimi, të klasifikuara të tilla sipas legjislacionit në fuqi.

5. “Siguria kombëtare” është tërësia e veprimeve shtetërore, që synon mbrojtjen e lirisë dhe të mirëqenies së qytetarëve, duke garantuar mbrojtjen



e vendit, parimet e vlerat kushtetuese, sigurinë ekonomike, energjetike, ushqimore, kibernetike, mjedisore, si dhe marrëdhëniet me jashtë të Republikës së Shqipërisë.

6. “Autoritet Klasifikues” është Presidenti, Kryeministri dhe çdo drejtues institucioni i autorizuar nga Kryeministri apo që e ka marrë këtë të drejtë me anë të delegimit.

7. “Komisioni për Klasifikimin ‘Sekret shtetëror’ të Informacionit” (në vijim “Komisioni”) ngrihet dhe drejtohet nga Autoriteti Klasifikues.

KREU II AUTORITETI KLASIFIKUES DHE DELEGIMI I TIJ

Neni 4 Autoriteti Klasifikues

1. Autoriteti për klasifikimin e informacionit mund të ushtrohet vetëm nga:

- a) Presidenti;
- b) Kryeministri.

2. Drejtuesit e ministrive ose të institucioneve të tjera shtetërore bëhen Autoriteti Klasifikues vetëm me autorizim të Kryeministrit.

3. Çdo institucion shtetëror, kur e gjykon se aparati dhe strukturat në varësi të tij prodhojnë informacion që lidhet me sigurimin kombëtar dhe që duhet të klasifikohet “Sekret shtetëror”, i paraqet kërkesë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me qëllim që titullari i institucionit të pajiset nga Kryeministri me autorizimin “Autoritet Klasifikues”.

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar shqyrton kërkesën e paraqitur nga institucioni dhe, kur e gjen të bazuar në ligj dhe në aktet nënligjore, i propozon Kryeministrit lëshimin e autorizimit “Autoritet Klasifikues” për titullarin e institucionit.

5. Në rast se kërkesa nuk gjendet e bazuar në ligj, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar i kthen përgjigje institucionit brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, duke i shpjeguar arsyet e mospranimit të kërkesës. Institucioni ka të drejtën e ankimit te Kryeministri, i cili vendos.

6. Drejtuesi i institucionit, që ka marrë autorizimin nga Kryeministri “Autoritet Klasifikues”, ka të drejtë të kryesojë Komisionin

dhe të klasifikojë informacionin që prodhon aparati dhe të gjitha strukturat në varësi të tij.

Neni 5 Delegimi i Autoritetit Klasifikues

1. Drejtuesi i institucionit, i cili ka marrë autorizimin “Autoritet Klasifikues” nga Kryeministri, në raste të veçanta, mund t’ia delegojë këtë të drejtë me shkrim funksionarëve të lartë brenda institucionit për të kryesuar Komisionin.

2. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar mban Regjistrin Shtetëror të Informacionit të Klasifikuar, ku regjistrohen të gjithë titullarët e institucioneve që kanë marrë autorizimin nga Kryeministri “Autoritet Klasifikues” ose e kanë fituar këtë të drejtë me anë të delegimit.

KREU III KRIJIMI, PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË KLASIFIKIMIT TË INFORMACIONIT “SEKRET SHTETËROR”

Neni 6 Krijimi dhe përbërja e Komisionit të Klasifikimit të Informacionit “Sekret shtetëror”

1. Në çdo institucion shtetëror krijohet Komisioni për Klasifikimin e Informacionit “Sekret shtetëror”.

2. Komisioni krijohet vetëm në aparatin e institucionit që ka marrë të drejtën e klasifikimit origjinal.

3. Kryetari i Komisionit është “Autoriteti Klasifikues”.

4. Numri i anëtarëve të Komisionit duhet të jetë jo më pak se 7 (shtatë) persona, gjithmonë tek, ku njëri është sekretar.

5. Komisioni mblidhet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve dhe merr vendim me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

6. Urdhri për krijimin e Komisionit përmban funksionet organike të secilit anëtar.



Neni 7

Vendimi për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”

1. Komisioni shqyrton informacionet e propozuara për klasifikim dhe vendos për informacionin që duhet klasifikuar, rivlerësuar, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së klasifikimit. Në përfundim të shqyrtimit të informacionit të propozuar për klasifikim, sekretari i komisionit harton vendimin për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në institucion dhe strukturat e varësisë, ku përcaktohet emërtimi i informacionit, niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së klasifikimit.

2. Vendimi për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në institucion dhe në strukturat e varësisë nënshkruhet nga Autoriteti Klasifikues dhe anëtarët e Komisionit.

3. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtën e votës “pro” ose “kundër”. Anëtar, i cili voton “kundër”, duhet të paraqesë me shkrim arsyet e votimit “kundër”.

4. Informacioni në bazë të përmbajtjes, vlerave dhe të interesit shtetëror, klasifikohet në njërin nga katër nivelet e mëposhtme:

- a) “Tepër sekret”;
- b) “Sekret”;
- c) “Konfidencial”;
- ç) “I kufizuar”.

5. Për përcaktimin e “Sekretit shtetëror” nuk do të përdoret asnjë term tjetër.

6. Një kopje e vendimit për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” i dërgohet Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga miratimi i saj.

Neni 8

Afati i ruajtjes së klasifikimit

1. Në përcaktimin e afatit të ruajtjes së klasifikimit të merret për bazë pasoja që mund t'i sjellë sigurimit kombëtar ekspozimi i tij.

2. Afati i ruajtjes së klasifikimit fillon nga data e krijimit të informacionit të klasifikuar.

3. Me mbarimin e afatit të ruajtjes së klasifikimit, informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” nuk do të konsiderohet dhe të trajtohet si i deklasifikuar (i

zakonshëm), por duhet t'i nënshtrohet procesit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit.

KREU IV

LISTA E INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA “SEKRET SHTETËROR”

Neni 9

Klasifikimi i informacionit sipas listës së informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”

1. Lista e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në institucion dhe në strukturat e varësisë duhet të njihet nga të gjithë nëpunësit/punonjësit që prodhojnë dhe administrojnë informacion të klasifikuar. Çdo informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror” të prodhohet vetëm duke u bazuar në këtë listë.

2. Një dokument apo material, që të konsiderohet e trajtohet si informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror”, duhet të ndodhet në listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” të institucionit dhe të strukturave në varësi.

3. Institucionet shtetërore, që nuk kanë listë të informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”, kur marrin një kërkesë të klasifikuar, përgjigjen gjithashtu duhet ta kenë të klasifikuar. Në këtë rast niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së klasifikimit të këtij informacioni duhet të jetë i njëjtë me informacionin e ardhur dhe duhet prodhuar e administruar, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

4. Përkthimi, riprodhimi dhe fragmentizimi i një informacioni të klasifikuar përmban të gjitha shenjëzimet e tij dhe trajtohet si i tillë.

Neni 10

Ndryshimi i listës së informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”

1. Lista e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” ndryshohet në vazhdimësi, duke ndjekur procedurën përkatëse të parashikuar në këtë rregullore dhe duke njoftuar DSIK-në.

2. Kur një informacion është i klasifikuar, e gjithë praktika ku bën pjesë ai trajtohet në nivelin e këtij informacioni. Informacioni i paklasifikuar, pjesë e kësaj dosjeje, mund të shfrytëzohet me miratim të titullarit.



3. Kur në një praktikë ndodhen një ose disa informacione të klasifikuara “Sekret shtetëror”, e gjithë praktika konsiderohet e klasifikuar dhe merr nivelin më të lartë të klasifikimit të informacionit që ndodhet në të.

Neni 11

Llojet e informacionit, objekt i klasifikimit

1. Informacioni që lidhet me sigurimin kombëtar i nënshtrohet procesit të klasifikimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar. Objekt i procesit të klasifikimit janë:

a) raportet, analizat, informacionet etj. në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit Kombëtar dhe të komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë;

b) raportet, analizat, informacionet etj., në takimet dypalëshe ose shumëpalëshe me delegacionet e shteteve të huaja të strukturave shtetërore;

c) veprimtaria e shërbimeve informative dhe e institucioneve të tjera që u njihet me ligj e drejta e ushtrimit të kësaj veprimtarie, ku ekspozohen format e metodat e punës;

ç) burimet e informacionit në shërbimet informative dhe në strukturat e tjera parandaluese, gjurmuese e zbuluese;

d) dokumentacioni i krijuar nga strukturat shtetërore gjatë veprimtarisë informuese, parandaluese, gjurmuese dhe zbuluese;

dh) planet ushtarake, programet, hartat, planimetritë dhe informacione të tjera ushtarake që përmbajnë të dhëna me rëndësi operative e strategjike;

e) informacionet për planet e mbrojtjes me rëndësi strategjike dhe kapacitetet e Forcave të Armatosura;

ë) informacioni që lidhet me ndërtimin e përdorimin e materialeve kriptografike, çelësat kriptografikë të të gjitha formave, algoritmet, publikimet, modulet, pajisjet dhe sistemet kriptografike, të përdorura për mbrojtjen kriptografike të informacionit të klasifikuar;

f) vlerësimet strategjike të Forcave të Armatosura për kërcënimet, rreziqet dhe masat për përbalimin e tyre;

g) informacionet për gatishmërinë luftarake, pajisjen, modernizimin, kompletimin me forca, mjete të Forcave të Armatosura;

gj) çështjet kriptologjike, shkencore, teknologjike dhe ekonomike;

h) informacionet lidhur me substancat e ndryshme kimike, biologjike, nukleare të rrezikshme për jetën dhe mjedisin;

i) planimetritë, skemat dhe projektet për objektet e rëndësisë së veçantë dhe të infrastrukturës kritike;

j) planet për sigurimin e personaliteteve të larta shtetërore të vendit dhe të huaj;

k) programi për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë;

l) sasia në prerje dhe vlera e stokut të kartëmonedhës dhe të monedhës metalike kombëtare;

ll) veprimtaria e përgjimit parandalues të telekomunikimeve;

m) informacioni që lidhet me kërcënimet, dobësitë, riskun, incidente sigurie të sistemeve/pajisjeve që trajtojnë informacion të klasifikuar;

n) informacioni që lidhet me gjendjen, kapacitetet, operimin dhe vlerësimin e sigurisë së sistemeve/pajisjeve që trajtojnë informacion të klasifikuar;

nj) planet dhe skemat e sigurisë fizike të zonave të sigurisë për informacionin klasifikuar;

o) planet e evakuimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, Bashkimit Evropian, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare;

p) pajisjet, fjalëkalimet, kodet dhe mediat kompjuterike që ruajnë informacion të klasifikuar;

q) tabela e organizimit të pajisjeve (në vijim “TOP”) dhe struktura e institucioneve të inteligjencës;

r) shërbimet, punët, mallrat, që kanë lidhje me sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, Bashkimit Evropian, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, kontratat në funksion të tyre dhe dokumentacioni për kontratat e klasifikuara.

rr) regjistrat dhe librat për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, pas plotësimit të tyre.

2. Komisioni për klasifikimin “Sekret shtetëror” të informacioneve ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vendosë për klasifikimin e informacioneve edhe për çështje që nuk janë parashikuar në pikën 1, të këtij neni, por që lidhen me sigurinë kombëtare.



KREU V
KLASIFIKIMI I PREJARDHUR DHE
PROPOZIMET
PËR KLASIFIKIM

Neni 12
Klasifikimi i prejardhur

1. Klasifikimi i prejardhur është përcaktimi që informacioni në thelb është i njëjtë me informacionin e klasifikuar më parë.

2. Informacioni i klasifikuar gjatë administrimit nga personat e autorizuar mund të gjenerohet në formë tjetër, por gjithmonë duke ruajtur të gjitha shenjëzimet e informacionit të parë.

Neni 13
Propozimi i shtetasve

1. Çdo shtetas apo nëpunës i Republikës së Shqipërisë, kur çmon se një informacion i caktuar nën kontrollin e shtetit ose jashtë tij ka vlerat e nevojshme për t'u klasifikuar, i propozon institucionit përkatës klasifikimin e tij.

2. Ky institucion vendos brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, nëse informacioni do të klasifikohet ose jo dhe njofton shtetasin apo nëpunësin për vendimin e marrë.

Neni 14
Propozimi i strukturave shtetërore

1. Strukturat në varësi të institucionit, në qendër dhe bazë, i propozojnë Komisionit llojet e informacionit që gjykojnë se duhen klasifikuar “Sekret shtetëror”, ku përcaktojnë emërtimin e informacionit, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së klasifikimit.

2. Komisioni për klasifikimin “Sekret shtetëror” të informacionit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, merr në shqyrtim propozimet e bëra për klasifikim nga strukturat e varësisë dhe vendos nëse duhen klasifikuar apo jo.

KREU VI
NDALIMET E KLASIFIKIMIT TË
INFORMACIONIT DHE HEQJA
E TYRE NGA LISTA

Neni 15
Ndalimet e klasifikimit

1. Autoriteteve klasifikuese u ndalohet të klasifikojnë informacion që nuk lidhet me sigurimin kombëtar.

2. Ndalohet klasifikimi i një informacioni kur ai bëhet, me qëllim që:

a) të fshehë dhunimin e ligjeve, paefektshmërinë apo gabimet e administratës;

b) t'i privojë të drejtën e njohjes një personi, organizate apo institucioni;

c) të pengojë apo të vonojë dhënien e informacionit që nuk kërkon mbrojtje në interes të sigurimit kombëtar.

Neni 16
Roli i DSIK-së në procesin e klasifikimit

1. Në rast se një institucion shtetëror klasifikon informacione në kundërshtim me dispozitat ligjore për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) i kërkon Autoritetit Klasifikues, që:

a) të heqë ose të shtojë nga lista e informacioneve të klasifikuara të institucionit informacionet e klasifikuara në kundërshtim me ligjin;

b) të ndryshojë nivelin e klasifikimit të informacioneve;

c) të ndryshojë afatin e ruajtjes së klasifikimit të informacioneve.

2. Në rast mosmarrëveshje ndërmjet Autoritetit Klasifikues dhe drejtorit të DSIK-së, vendos Kryeministri.



KREU VII

SHENJËZIMET E INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”

Neni 17

**Shenjëzimet e informacionit të klasifikuar
“Sekret shtetëror”**

1. Informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, që të identifikohet si i tillë, duhet të përmbajë këto shenjëzime:

- a) stemën e Republikës së Shqipërisë;
- b) intestimin “Republika e Shqipërisë”;
- c) emërtimin e institucionit shtetëror dhe të strukturës përkatëse (nëse ka të tillë);
- ç) numrin e regjistrimit (protokollit) të korrespondencës (në anën e majtë);
- d) nivelin e klasifikimit (në anën e djathtë);
- dh) afatin e ruajtjes së klasifikimit (në anën e djathtë);
- e) numrin e kopjes (në anën e djathtë);
- ë) vendin dhe datën (në anën e djathtë);
- f) lëndën;
- g) adresën e korrespondentit;
- gj) emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan informacionin dhe nënshkrimin e tij;
- h) vulën e institucionit prodhues.

2. Në fundin e kopjes së informacionit që qëndron në Zyrën e Informacionit të Klasifikuar, në anën e majtë, shkruhen edhe shenjëzimet e mëposhtme:

- a) konceptoi;
- b) printoi;
- c) eprori më i afërt (përgjegjës sektori, kryetar dege etj.);
- ç) eprori direkt (drejtor departamenti, drejtorie etj.);
- d) numri i kopjeve të prodhuara;
- dh) numri i lidhjeve për çdo kopje (nëse ka).

3. Niveli i klasifikimit në çdo informacion të klasifikuar vendoset në fundin e faqes së parë, si dhe në fillimin e fundin e çdo faqeje pasardhëse.

4. Informacionet e klasifikuara, që krijohen, qarkullojnë dhe administrohen vetëm brenda ministrisë apo institucionit, kanë të gjitha shenjëzimet identifikuese të informacioneve të klasifikuara që dërgohen apo hyjnë në ministri apo institucion e janë në përputhje me modelin e përcaktuar nga DSIK-ja.

KREU VIII

SHKELJET E SIGURISË

Neni 18

Shkeljet e sigurisë

1. Moszbatimi i kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore përbën shkelje sigurie për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”.

2. Shkeljet e sigurisë të rënda në moszbatimin e kësaj rregulloreje konsiderohen:

a) miratimi i listës së informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;

b) klasifikimi i informacioneve që nuk kanë lidhje me sigurimin kombëtar;

c) klasifikimi me qëllim fshehjen e dhunimit të ligjeve, paefektshmërinë apo gabimet e administratës, t’i privojë të drejtën e njohjes një personi, organizate apo institucioni, të pengojë apo të vonojë dhënien e informacionit që nuk kërkon mbrojtje në interes të sigurimit kombëtar;

ç) prodhimi i një informacioni të klasifikuar “Sekret shtetëror”, pa u bazuar te lista e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” të institucionit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në rregullore;

d) mosvendosja e shenjëzimeve në informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”;

dh) mosklasifikimi i informacionit që lidhet me sigurinë kombëtare.

Neni 19

Dispozita të fundit

1. Ngarkohen ministritë dhe institucionet shtetërore për zbatimin e kësaj rregulloreje.

2. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) për kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje.

3. Ngarkohen institucionet shtetërore për rishikimin e listës së informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”, në përputhje me këtë rregullore.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.



VENDIM
Nr. 264, datë 12.5.2021

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË PËRMET, TË NJËSISË
ADMINISTRATIVE FRASHËR, TË DISA
PRONAVE ME VENDNDODHJE NË
ZONËN KADASTRALE 2822**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Përmët, të Njesisë Administrative Frashër, të disa pronave me vendndodhje në zonën kadastrale 2822, sipas formularit, gjithsej 1 (një) fletë, dhe planrilevimeve, bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në fushën e bujqësisë.

2. Ngarkohen Bashkia Përmët dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETETORE

Bashkia Permet				Identifikoi: Adriatik Bakushi, Specialist Hartograhje (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Supervizor: Sotirag Zenuni, Përgjegjës I Asistencës (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Aprovoi: Alma Hoxha Kryetar Bashkie (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tërësi, shprehje, vula)		
Fusha e përdorimit të Pronës: Bujqësi										
A				B		C				
Nr. Rend.	Zona Kadastrale & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës m ²	Nga Sip. Totale sa Ndertese (m ²)	Funks. për të cilin përdoret Prona	Instituc. / Enti me përgjegjësi administrative	Instituc. / Enti përdorues Statusi Juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Z.K. 2822 125-(255-A)		Are	Selenice, Frasher, Bashkia Permet	56900		Bujqësi	Bashkia Permet	Bashkia Permet	Revanize poshte
2	Z.K. 2822 125-(255-A)		Are	Selenice, Frasher, Bashkia Permet	6720		Bujqësi	Bashkia Permet	Bashkia Permet	Revanize lart
3	Z.K. 2822 125-(255-A)		Are	Selenice, Frasher, Bashkia Permet	12400		Bujqësi	Bashkia Permet	Bashkia Permet	Kungullore
4	Z.K. 2822 125-(255-A)		Are	Selenice, Frasher, Bashkia Permet	36640		Bujqësi	Bashkia Permet	Bashkia Permet	Nishani
5	Z.K. 2822 125-(255-A)		Are	Selenice, Frasher, Bashkia Permet	9110		Bujqësi	Bashkia Permet	Bashkia Permet	Sede poshtme
6	Z.K. 2822 125-(255-A)		Are	Selenice, Frasher, Bashkia Permet	7920		Bujqësi	Bashkia Permet	Bashkia Permet	Sede e sipërme
7	Z.K. 2822 125-(255-A)		Are	Selenice, Frasher, Bashkia Permet	5700		Bujqësi	Bashkia Permet	Bashkia Permet	Sede e mesit
8	Z.K. 2822 125-(255-A)		Pemetore	Selenice, Frasher, Bashkia Permet	28570		Bujqësi	Bashkia Permet	Bashkia Permet	Pemetore



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE					
PRONARI	SHTETI	DATE 17/12/2020	QELLIMI: Inventarizim/regjistrim		
VENDNDODHJA					
BASHKIA PERMET	DVASHK/ZVASHK	PERMET	ZONA KADASTRALE 2822	NUMRI PASURISE	INDEKSI I HARTES K-34-125-(255-A)
TE DHENAT E PASURISE					
LLOJI I PASURISE	Are	Sip.Pasurise 36640m2	Sip.gjurmës së ndërtimit	Numri i kateve	Numri i pemeve

x=536789.985
y=4468146.455
1.3ha
x=537237.985
y=4468146.455

x=536789.985
y=4467801.355
Shk.1:2500
Sistemi koordinativ sipas K.RR.GJ.SH.2010

Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi i kufirit	KUFITARI	ID/NIPT	Shenime te realizuesit
				Veri: Pyll		Pasuria njihet me emrin popullor
				Lindje: Pemtores		"Nishani"
				Jug: Perroi nishanit		
				Perendim: Rruges		

REALIZOI PER Bashkine Permet

Emri: Adriatik Bakushi

Hartograf i Bashkise

REALIZOI PER ASHK

KONFIRMOI:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Ortofoto e matje direkte O,D

PERCAKTIMI I KUFIRIT

SHENIME TE VECANTA

PRONARI / B.PRONARET. DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI	SHTETI	DATE 17/12/2020	QELLIMI: Inventarizim/regjistrim			
VENDNDODHJA						
BASHKIA PERMET DVASHK/ZVASHK PERMET ZONA KADASTRALE 2822 NUMRI PASURISE _ INDEKSI I HARTES K-34-125-(255-A)						
TE DHENAT E PASURISE						
LLOJI I PASURISE Are		Sip.Pasurise 7920m2 Sip.gjurmese se nderimit		Numri i kateve		Numri i pemeve
X=536859.426 Y=4468362.895						X=537324.225 Y=4468362.895
X=536859.425 Y=4468006.595		Shk.1:2500		Sistemi koordinativ sipas K.RR.GJ.SH.2010		X=537324.225 Y=4468006.595
Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi i kufirit	KUFITARI	ID/NIPT	Shenime te realizuesit
				Veri: Pyll		Pasuria njihet me emrin populor
				Lindje: Sede e mesit		"Sede e sipërme"
				Jug: Pemtoe;pyll		
				Perendim: Pyll		
REALIZOI PER Bashkine Permet				TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Ortofoto e matje direkte O:D		
Emri: Adriatik Bakushi Hartograf i Bashkise				PERCAKTIMI I KUFIRIT		
REALIZOI PER ASHK				SHENIME TE VECANTA		
KONFIRMOI:				PRONARI / B.PRONARET. DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET		



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI	SHTETI	DATE 17/12/2020	QELLIMI: Inventarizim/regjistrim			
VENDNDODHJA						
BASHKIA PERMET DVASHK/ZVASHK PERMET ZONA KADASTRALE 2822 NUMRI PASURISE _ INDEKSI I HARTES K-34-125-(255-A)						
TE DHENAT E PASURISE						
LLOJI I PASURISE Are Sip.Pasurise 9110m2 Sip.gjurmës së ndërtimit _____ Numri i kateve _____ Numri i pemeve _____						

x=537215.997
y=4468252.967
x=537669.997
y=4468252.967

x=537215.997
y=4467911.367
x=537669.997
y=4467911.367

Shk.1:2500

Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi i kufirit	KUFITARI	ID/NIPT	Shenime te realizuesit
				Veri: Pyll		Pasuria njihet me emrin
				Lindje: Pyll		popullor "Sede e Poshtme"
				Jug: Pyll		
				Perendim: Pyll		

REALIZOI PER Bashkine Permet

Emri: Adriatik Bakushi
Hartograf i Bashkise

REALIZOI PER ASHK

KONFIRMO:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Ortofoto e matje direkte O,D

PERCAKTIMI I KUFIRIT


SHENIME TE VECANTA

PRONARI / B.PRONARET. DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI	SHTETI	DATE 17/12/2020	QELLIMI: Inventarizim/regjistrim
VENDNDODHJA			
BASHKIA PERMET	DVASHK/ZVASHK	PERMET	ZONA KADASTRALE 2822 NUMRI PASURISE _ INDEKSI I HARTES K-34-125-(255-A)
TE DHENAT E PASURISE			
LLOJI I PASURISE Are	Sip.Pasurise 56900m2	Sip.gjurmës së ndërtimit	Numri i kateve Numri i pemeve



Shk.1:5000

Sistemi koordinativ sipas K.RR.GJ.SH.2010

Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi i kufirit	KUFITARI	ID/NIPT	Shenime te realizuesit
				Veri: Pyll		Pasuria njihet me emrin populor
				Lindje: Toka ne pronesi 7501		"Revanize poshte"
				Jug: Pyll		
				Perendim: Pyll		

REALIZOI PER Bashkine Permet

Emri: Adriatik Bakushi

Hartograf i Bashkise

REALIZOI PER ASHK

KONFIRMO



TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Ortofoto e matje direkte O;D

PERCAKTIMI I KUFIRIT

SHENIME TE VECANTA

PRONARI / B.PRONARET. DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE					
PRONARI	SHTETI	DATE 17/12/2020	QELLIMI: Inventarizim/regjistrim		
VENDNDODHJA					
BASHKIA PERMET DVASHK/ZVASHK PERMET ZONA KADASTRALE 2822 NUMRI PASURISE _ INDEKSI I HARTES K-34-125-(255-A)					
TE DHENAT E PASURISE					
LLOJI I PASURISE Pentore Sip.Pasurise 28570m2 Sip.gjurmës së ndërtimit _____ Numri i kateve _____ Numri i pemeve _____					

x=536941.325
y=4468266.295
x=537409.625
y=4468266.295

x=536941.325
y=4467910.695
x=537409.625
y=4467910.695

Shk.1:2500 Sistemi koordinativ sipas K.RR.GJ.SH.2010

Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi i kufirit	KUFITARI	ID/NIPT	Shenime të realizuesit
				Veri: Sede e Sipërme		Pasuria njihet me emrin popullor
				Lindje: Sede e mesit		"Pentore"
				Jug: Pyll		
				Perendim: Nishani		

REALIZOI PER Bashkinë Permet

Emri: Adriatik Bakushi

Hartograf i Bashkisë

REALIZOI PER ASHK

KONFIRMOI

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Ortofoto e matje direkte O;D

PERCAKTIMI I KUFIRIT

SHENIME TE VECANTA

PRONARI / B.PRONARET. DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI	SHTETI	DATE 17/12/2020	QELLIMI: Inventarizim/regjistrim			
VENDNDODHJA						
BASHKIA PERMET DVASHK/ZVASHK PERMET ZONA KADASTRALE 2822 NUMRI PASURISE _ INDEKSI I HARTES K-34-125-(255-A)						
TE DHENAT E PASURISE						
LLOJI I PASURISE Are Sip.Pasurise 6720m2 Sip.gjurmës së ndërtimit _____ Numri i kateve _____ Numri i pemeve _____						
x=537282.897 y=4469022.267		x=537742.797 y=4469022.267				
Shk. 1:2500 Sistemi koordinativ sipas K.RR.GJ.SH.2010						
Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi i kufirit	KUFITARI	ID/NIPT	Shenime te realizuesit
				Veri: Pyll		Pasuria njihet me emrin popullor
				Lindje: Pyll		"Revanize Lart"
				Jug: Pyll		
				Perendim: Pyll		
REALIZOI PER Bashkine Permet				TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Ortofoto e matje direkte O,D		
Emri: Adriatik Bakushi Hartograf i Bashkise				PERCAKTIMI I KUFIRIT		
				SHENIME TE VECANTA		
REALIZOI PER ASHK						
KONFIRMOI:				PRONARI / B.PRONARET. DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET		



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI	SHTETI	DATE 17/12/2020	QELLIMI: Inventarizim/regjistrim			
VENDNDODHJA						
BASHKIA PERMET	DVASHK/ZVASHK	PERMET	ZONA KADASTRALE 2822	NUMRI PASURISE	INDEKSI I HARTES K-34-125-(255-A)	
TE DHENAT E PASURISE						
LLOJI I PASURISE	Are	Sip.Pasurise 12400m2	Sip.gjurmës së ndërtimit	Numri i kateve	Numri i pemeve	

x=536747.228
y=4468021.125
x=537205.028
y=4468364.238

x=536747.228
y=4468021.125
x=527205.028
y=4468021.125

Shk.1:2500

Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi i kufirit	KUFITARI	ID/NIPT	Shenime te realizuesit
				Veri: Pyll		Pasuria njihet me emrin popullor
				Lindje: Pyll		"Kungullore"
				Jug: Pyll		
				Perendim: Pyll		

REALIZOI PER Bashkine Permet

Emri: Adriatik Bakushi
Hartograf i Bashkise

REALIZOI PER ASHK

KONFIRMOI:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Ortofoto e matje direkte O/D

PERCAKTIMI I KUFIRIT

SHENIME TE VECANTA

PRONARI / B.PRONARET. DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI	SHTETI	DATE 17/12/2020	QELLIMI: Inventarizim/regjistrim			
VENDNDODHJA						
BASHKIA PERMET DVASHK/ZVASHK PERMET ZONA KADASTRALE 2822 NUMRI PASURISE _ INDEKSI I HARTES K-34-125-(255-A)						
TE DHENAT E PASURISE						
LLOJI I PASURISE Are Sip. Pasurise 5700m2 Sip. gjurmes se ndertimit _____ Numri i kateve _____ Numri i pemeve _____						
x=537007.825 y=4468318.095 x=537476.125 y=4468318.095						
x=537007.825 y=4467977.795 x=537476.125 y=4467977.795						
Shk.1:2500 Sistemi koordinativ sipas K.RR.GJ.SH.2010						
Nr.	Orientimi	Perdorimi	Tipi i kufirit	KUFITARI	ID/NIPT	Shenime te realizuesit
				Veri: Pyll		Pasuria njihet me emrin popullor
				Lindje: Pyll		"Sede e mesit"
				Jug: Pemtoze		
				Perendim: Sede siperme		
REALIZOI PER Bashkine Permet				TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Ortofoto e matje direkte O:D		
Emri: Adriatik Bakushi Hartograf i Bashkise				PERCAKTIMI I KUFIRIT		
REALIZOI PER BASHK				SHENIME TE VECANTA		
KONFIRMIM:				PRONARI / B.PRONARET. DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET		

**VENDIM**

Nr. 265, datë 12.5.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 58, DATË 27.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA GRAMSH, TË PRONËS NR. 334, ME EMËRTIM ‘ISH-REPARTI USHTARAK NR. 9920, GRUP DEPO’, ME VENDNDODHJE ‘PËRROI I ÇEKREZIT’”, GRAMSH, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “g”, 7, 11 e 12, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 58, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... për ndërtimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane, në territorin e Bashkisë Gramsh ...” zëvendësohen me “... në fushën e shërbimit funeral ...”.

2. Ngarkohen Bashkia Gramsh dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 266, datë 12.5.2021

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE BERAT, TË PASURISË ME NR. 24/220, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8502, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 834, DATË 21.11.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BERAT, TË QARKUT TË BERATIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Berat, për njësinë administrative Berat, të pasurisë me nr. 24/220, me vendndodhje në zonën kadastrale 8502, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe plan-rilevimit, bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në fushën e strehimit dhe shërbimeve sociale.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 834, datë 21.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat të qarkut të Beratit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Bashkia Berat dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



1.FORMULARE PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

Bashkia / : BERAT

Fusha e perdorimit te Prones:

"Shesh per ndertimin e banesave per familjet e pastreha"

Identifikoi: Meleqe Spahiu(Drejtores e Emergjencave Pronave dhe Transporti)

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Ervin Demo (Kryetar i Bashkise Berat)

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)



Nr. Rend.	A			B			C		
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa truall (m2)	Funksioni per te cilin do perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	8502 BR M-8,9	24/220	Shesh	Lagja "30 Vjetori" Berat	3930.3	3930.3	Shesh per ndertimin e banesave per familjet e pastreha	Bashkia Berat	Bashkia Berat ne pronesi



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : SHTET **DATE 15.02.2021** **QELLI MI PER REGJISTRIM**

VENDODHJA BASHKIA BERAT DVASHK:BERAT ZONA KADASTRALE : 8502 NUMRI I PASURISE 24/220
 TE DHENAT E PASURISE LLOJI I PASURISE : SHESH SIP.PAS=3930.30m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= INDEX HARTE:BR-M-9
 NUMRI KATEVE :0

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

x=497560.21 y=4507014.76 x=497760.19 y=4507014.76

SH 1:1000

x=497560.21 y=4506871.53 x=497760.19 y=4506871.53

NR.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			24/47		
2	JUG			125		
3	LINDJE			24/67		
4	PERENDIM			24/59		

BASHKIA BERAT
 EMRI: SPECIALIST DEJNI ZILYFTARI *Dej*
 LICENCA:NR _____ DATE _____
 KOMPANIA: Specialist i Bashkise
 NENSHKRIMI/VULA _____
 REALIZOI PER ASHK
 SPECIALISTI
 DVASHK
 NENSHKRIMI
 KONFIRMOI
 PERGJEGJS/DREJTORI
 NENSHKRIMI/VULA _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE : T,Z,O
 Kode per teknologjine e matjeve: T-terren: Zyre: O-Ortofoto:G-GPS:S-Station Total: D-Matje Distancash
 Percaktimi i kufirit:HK
 Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve:K-Kufitare te gjithë:KP-kufitare pjaserisht:PB-Perfaqesues Bashkie, HK-Harta Kadastrale
 Shenime te vecanta
 PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI VAREDET E MATJEVE KUPITARET
 EMRI BASHKIA BERAT
 KRYETARI BASHKISE:ERVIN DEJ
 NENSHKRIMIA _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit : T-Terren: Z-Zyre:O-Ortofoto:G-Gps:S-Station Total: D-Matje Distancash:P-Perfaqesuesi i Pronave:
 K-Kufitare te gjithë: KP-Kufitare Pjaserish:PB-Perfaqesues Bashkie, HK-Harta kadastrale



VENDIM
Nr. 267, datë 12.5.2021

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHETËRORE “REGJISTRI I
OFRUESVE TË SHËRBIMIT INOVATIV
DHE SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE
TË AUTOMATIZUARA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të neneve 22 e 106, pika 1, të ligjit nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, me propozimin e zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri i ofruesve të shërbimit inovativ dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara” (në vijim “baza e të dhënave”).

2. Në zbatim të neneve 25 e 27, të ligjit nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, ky vendim përcakton:

a) bazën e të dhënave shtetërore të përbërë nga:

i. Regjistri i Ofruesve të Shërbimit Inovativ; dhe

ii. Regjistri i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive të Automatizuara.

b) kërkesat e nevojshme ligjore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

3. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Autoritetet përgjegjëse”, autoritetet kombëtare me përgjegjësi të caktuara lidhur me informacionin, procedurat, asistencën që mbulon ky vendim;

b) “Administrimi i bazës së të dhënave”, menaxhimi nga autoriteti publik i bazës së të dhënave, që përmban të gjitha llojet e aksesit në sistemin e bazës së të dhënave, përfshirë përditësimin e ndryshimin e informacionit të ruajtur;

c) “Dhënës i informacionit”, një person publik apo privat, siç përcaktohet në këtë vendim, për të dhënë informacionin në bazën e të dhënave;

ç) “Institucioni administrues”, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), që është përgjegjëse për administrimin e bazës së të dhënave;

d) “Kodi unik i ofruesve të shërbimit inovativ”, kodi i gjeneruar automatikisht nga sistemi pas çdo aplikimi për licencë;

dh) “Kodi unik i sipërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara”, kodi unik identifikues pas çdo aplikimi për licencë në sistem;

e) “Ndërveprim”, procesi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet bazave të të dhënave;

ë) “Palë e interesuar”, çdo person fizik ose person juridik, i cili lejohet të ketë akses të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave siç përcaktohet në këtë vendim;

f) “Të dhënat parësore” dhe “Të dhënat dytësore”, i njëjti kuptim me termat e parashikuar në nenin 3, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

4. Të dhënat parësore janë të dhënat e mbledhura nga AKSHI, sipas ligjit nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, dhe këtij vendimi. Të dhëna parësore janë të dhënat e mëposhtme:

a) Kodi unik i ofruesve të shërbimit inovativ, referuar kërkesës për licencim;

b) Kodi unik i sipërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara, referuar kërkesës për licencim;

c) Numri i protokollit/eve dhe data/t e vendimeve të marra nga autoriteti përgjegjës që ka lëshuar licencën përkatëse;

ç) Kodi unik i licencimit;

d) Referimi i çdo vendimi tek autoritetet përgjegjëse, nëpërmjet të cilit këto autoritete kanë ndërmarrë sanksione ndaj titullarit të licencës, në përputhje me këtë ligj;

dh) Konfirmimi i marrjes në kohë të deklaratës së përputhshmërisë së titullarit të licencës, nëse kërkohet.

5. Të dhëna dytësore, të cilat merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore, dhe me të cilat ndërvepron janë, si më poshtë vijon:

a) Të dhënat e individit nga baza e të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”, të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

b) Të dhënat nga regjistri i personit fizik/tregtar apo juridik nga baza e të dhënave shtetërore



“Regjistri tregtar”, të administruara nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

c) Të dhënat nga baza e të dhënave shtetërore “Tatimi elektronik”, të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për subjektet e regjistruara pranë saj;

d) Çdo bazë tjetër të dhënash, që mund të ndërveprojë me bazën e të dhënave shtetërore “Regjistri i Ofruesve të Shërbimit Inovativ dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive të Automatizuara” dhe të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

6. Baza e të dhënave administrohet nga AKSHI.

7. Të gjitha veprimet e kryera në bazën e të dhënave janë të gjurmueshme dhe të dokumentuara.

8. Veprimet e kryera në bazën e të dhënave regjistrohen dhe ruhen nga AKSHI, duke përdorur kodin identifikues të personit të ngarkuar që ka kryer veprimin, datën e orën e konsultimit, fjalët kyç të përdorura për kërkimin, numrin e dosjes dhe të dhënat e konsultuara.

9. AKSHI është përgjegjës për menaxhimin, në përputhje me këtë vendim, të aksesit në bazën e të dhënave. Në rast të konstatimit të veprimeve të paligjshme, pezullon menjëherë aksesin e personit, i cili ka vepruar në kundërshtim me ligjin apo udhëzimet e procedurat për administrimin e bazës së të dhënave. Pezullimi i aksesit nuk përjashton përgjegjësinë disiplinore, civile ose penale.

10. Dhënësit e informacionit janë personat përgjegjës, të cilët kanë të drejta sipas rregullores dhe përditësimi i bazës së të dhënave do të kryhet në përputhje me rregullat specifike të parashikuara sipas ligjit nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”. Rregullat e brendshme për organizimin dhe funksionimin e bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen me rregullore të veçantë, e cila miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t.

11. AKSHI, si institucion administrues i bazës së të dhënave, pas kryerjes dhe bazuar në rezultatet e analizës së sigurisë, përcakton nivelet e sigurisë dhe klasat/nënklasat e sigurisë së të dhënave, siç parashikohet në dispozitat e kapitullit V, të vendimit nr. 945, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore’”, të ndryshuar.

12. Nivelet e sigurisë së të dhënave mund të jenë i lartë (L), mesatar (M) dhe i ulët (U). Niveli i sigurisë së të dhënave përcaktohet në bazë të parametrevave të integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë.

13. Niveli i aksesit në bazën e të dhënave është, si më poshtë vijon:

a) AKSHI ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave në rolet:

- i. administrator;
- ii. editues;
- iii. lexues;

b) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me të drejta vetëm për shikim (lexues) të të dhënave;

c) Publiku me të drejta leximi për të dhënat të përcaktuara në nenin 22, të ligjit nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

14. Baza e të dhënave shtetërore aksesohet nga të gjitha institucionet e interesuara, nëpërmjet kërkesës drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, në përputhje me rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore të përcaktuar nga AKSHI dhe kuadrit ligjor rregullues përkatës.

15. AKSHI, në cilësinë e “kontrolluesit”, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, dokumenton masat tekniko-organizative të përshtatura e të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

16. Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale kryhen në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

17. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM

Nr. 268, datë 12.5.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
SULLTANATIT TË OMANIT, MBI
PËRJASHTIMIN E NDËRSJELLË TË
VIZAVE PËR MBAJTËSIT E
PASAPORTAVE DIPLOMATIKE,
SPECIALE DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Sulltanatit të Omanit, mbi përjashtimin e ndërsjellë të vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, speciale dhe të shërbimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SULLTANATIT TË OMANIT
MBI PËRJASHTIMIN E NDËRSJELLË TË
VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE, SPECIALE DHE TË
SHËRBIMIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Sulltanatit të Omanit (këtu e tutje referuar si “Palët”),

duke dashur të promovojnë marrëdhëniet dypalëshe,

duke dashur të lehtësojnë udhëtimin e shtetasve të tyre, mbajtës të pasaportave diplomatike, speciale dhe të shërbimit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për mbajtësit e ndonjë prej pasaportave të mëposhtme:

1. Pasaportat e vlefshme diplomatike dhe të Shërbimit të Republikës së Shqipërisë;
2. Pasaporta të vlefshme diplomatike, speciale dhe të shërbimit të Qeverisë së Sulltanatit të Omanit.

Neni 2

1. Shtetasit e secilës Palë, mbajtës të ndonjë prej pasaportave të përmendura në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, do të hyjnë në territorin e Palës tjetër pa vizë dhe do të qëndrojnë për një periudhë maksimale prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë nga dita e hyrjes.

2. Shtetasit e secilës Palë, të referuara në paragrafin e mësipërm, të cilët synojnë të qëndrojnë për një periudhë më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë në territorin e Palës tjetër, do t’iu nënshtrohen procedurave të nevojshme për kërkesë për vizë nga autoritetet kompetente të Palës tjetër para skadimit të periudhës 90-ditore (nëntëdhjetëditore).

Neni 3

1. Shtetasit e secilës Palë, mbajtës të ndonjë prej pasaportave të përmendura në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, të punësuar në misione diplomatike dhe konsullore dhe organizata ndërkombëtare që kanë selitë e tyre në territorin e Palës tjetër, kanë të drejtë të hyjnë në territorin e vendit të Palës tjetër pa vizë.

2. Përjashtimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të zbatohet, gjithashtu, për anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta në të njëjtën familje, mbajtës të ndonjë prej pasaportave të referuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Shtetasit e secilës Palë, mbajtës të ndonjë prej pasaportave të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, nuk duhet të ndërmarrin ndonjë veprimtari të paguar që kërkon një leje pune gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Palës tjetër.



Neni 5

Shtetasit e secilës Palë, mbajtës të ndonjë prej pasaportave të përmendura në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, do të hyjnë, qëndrojnë, largohen dhe lëvizin transit përmes territorit të Palës tjetër në çdo pikë kufitare të përdorur për lëvizje ndërkombëtare.

Neni 6

1. Shtetasit e secilës Palë, mbajtës të ndonjë prej pasaportave të përmendura në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje do të respektojnë ligjet dhe rregulloret e tjera të Palës tjetër gjatë qëndrimit në territorin e asaj Pale.

2. Kjo Marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën e Palëve për të refuzuar hyrjen ose për të anuluar qëndrimin për një shtetas të Palës tjetër të cilin mund ta konsiderojë persona *non grata*.

Neni 7

1. Me qëllim të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, paqes dhe rendit publik dhe shëndetit të tyre, Palët do të kenë të drejtën të pezullojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje pjesërisht ose plotësisht.

2. Palët informojnë menjëherë njëra-tjetrën për vendimin për të pezulluar këtë Marrëveshje pjesërisht ose plotësisht ose për rihyrjen e saj në fuqi përmes kanaleve diplomatike.

Neni 8

1. Palët do të shkëmbejnë ekzemplarët e pasaportave të tyre të referuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje përmes kanaleve diplomatike.

2. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për ndryshimin e këtyre ekzemplarëve 60 (gjashtëdhjetë) ditë para se ndryshimi të hyjë në fuqi.

3. Palët do të shkëmbejnë ekzemplarë të pasaportave të reja ose të ndryshuara, të përmendura në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë të dhëna për përdorimin e tyre të paktën 30 (tridhjetë) ditë para prezantimit të specimeneve.

Neni 9

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e Marrëveshjes do të zgjidhen përmes kanaleve diplomatike.

Neni 10

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve nga protokolle shtesë ose shkëmbime notash diplomatike, të cilat do të konsiderohen si pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një afat të pacaktuar kohor. Secila palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke i dërguar njoftime me shkrim Palës tjetër përmes kanaleve diplomatike. Përfundimi do të zbatohet pas 30 (tridhjetë) ditësh nga data e marrjes së njoftimit të tillë nga pala tjetër.

Neni 12

Kjo Marrëveshje nuk do të paragjykojë detyrimet e Palëve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, veçanërisht detyrimet në zbatim të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, të datës 18 prill 1961, dhe të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, të datës 24 prill 1963.

Neni 13

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, me anë të të cilit palët informojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme përkatëse.

Bërë në Riad, më 31.3.2021, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip, arabisht dhe anglisht, të gjitha tekstet janë të barasvlershme. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim, prevalon teksti në anglisht.

PËR KËSHILLIN E
MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E
SULLTANATIT TE
OMANIT



VENDIM

Nr. 269, datë 12.5.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 94, DATË 4.2.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PROCEDURAT PËR ARMËT NË
RASTET E DEKLARIMIT TË VDEKJES,
DEKLARIMIT TË MBYLLJES LIGJORE
TË AKTIVITETIT, PËR QËLLIME
STUDIMORE, TË HUMBJES SË ARMËS,
VJEDHJES SË SAJ APO
DOKUMENTIT/AUTORIZIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 44, të ligjit nr. 74/2014, datë 10.7.2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 94, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në kreun I bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Në rast vdekjeje të pronarit të armës, një pjesëtar madhor i familjes së tij ose përfaqësuesi i tij ligjor, kujdestari i të miturit apo personit që i është hequr zotësia apo ka zotësi të kufizuar, personi që ka jetuar me të në të njëjtën banesë ose personi tek i cili gjendej arma në momentin e vdekjes, si edhe çdo person që ka dijeni për ekzistencën e një arme në pronësi të personit të vdekur është i detyruar që, brenda 10 (dhjetë) ditëve, të njoftojë *online* në Portalin Unik Qeveritar *e-Albania* ose strukturën vendore të policisë ku janë regjistruar armët, nëse dihet, ose strukturën e policisë ku ka vendbanimin personi që ka humbur jetën.”

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Armët, pjesët përbërëse të tyre, tërhiqen nga punonjësi i policisë së njësisë ku janë regjistruar dhe merren në ruajtje, në pritje të trashëgimtarit për t'i marrë e regjistruar në pronësi. Në momentin e dorëzimit të tyre organi përgjegjës për armën dhe municionin e dorëzuar pajis dorëzuesin me një vërtetim.”

c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Trashëgimtari i vetëm i armës, pjesëve përbërëse të saj, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga momenti i pranimit të trashëgimisë apo i përfundimit të afateve për heqjen dorë nga trashëgimia, si dhe kujdestari ligjor i trashëgimtarit, të cilit i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar, me vendim gjyqësor detyrohet të kryejë një nga veprimet e mëposhtme:

a) të tjetërsojë armën, pjesët përbërëse të saj dhe municionin; ose

b) të paraqesë kërkesë për pajisjen me autorizim për “mbajtje arme”; ose

c) të dorëzojë armën për ta çaktivizuar; ose

ç) t'ia dorëzojë armën, pjesët përbërëse të saj dhe municionin, Drejtorisë Vendore të Policisë ku ka vendbanimin, pa asnjë kundërshtpërblim.”

ç) Pas pikës 3 shtohen nënparagrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4 dhe 3.5, me këtë përmbajtje:

“3.1 Në rast se trashëgimtari i armës dhe municionit është i mitur, arma, pjesët e tyre dhe municioni do të qëndrojnë në ruajtje pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit deri sa i mituri të arrijë moshën për t'u pajisur me autorizim për armë. Trashëgimtari i armës, me arrijtjen e moshës 25 vjeç, është i detyruar që të veprojë sipas përcaktimeve në pikën 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, të këtij vendimi.

3.2 Kur trashëgimtari i armës e tjetërson atë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shites, detyrohet ta çregjistrojë armën në fjalë nga regjistri i armëve, pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit.

3.3 Kur trashëgimtari i armës paraqet kërkesë për pajisjen me autorizim “mbajtje arme”, organi përgjegjës i Policisë së Shtetit e pajis me autorizimin përkatës nëse përmbush kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar.

3.4 Nëse trashëgimtari i armës dëshiron ta mbajë atë si relike, duhet ta çaktivizojë atë në mënyrë të përhershme dhe, brenda 5 (pesë) ditëve, ta çregjistrojë pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit. Shpenzimet e çaktivizimit të armës mbulohen nga kërkuesi.

3.5 Arma, që trashëgimtari i dorëzon Drejtorisë Vendore të Policisë ku ka vendbanimin, pa asnjë kundërshtpërblim, çregjistrohet nga regjistri i armëve pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit.”

2. Pika 5, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:



“5. Subjekti, me mbylljen ligjore të aktivitetit, bën njoftimin *online* për strukturën e Policisë së Shtetit, e cila me marrjen dijeni nga subjekti dhe në prezencë të tij bën menjëherë, por jo më vonë se 24 orë nga marrja dijeni, bllokimin e armëve të lejuara, së bashku me municionet e tyre, kundrejt procesverbalit përkatës, ku një kopje e tij i jepet të interesuarit.”.

3. Në kreun IV bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në fund të pikës 14, shtohen fjalët “... ose *online* në Portalin Unik Qeveritar *e-Albania*.”.

b) Në fund të pikës 17 shtohen fjalët “... ose *online* në Portalin Unik Qeveritar *e-Albania*.”

II. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 270, datë 12.5.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 96, DATË 4.2.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE
PROCEDURAVE TË DEKLARIMIT,
RUAJTJES, REGJISTRIMIT DHE
PAAFTËSIMIT PËR ARMËT
E KOLEKSIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 45, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 96, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “b”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Të jenë armë të cilat kanë kryer procedurat e regjistrimit si objekte të deklaruara pasuri kulturore pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK).”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Personi fizik dhe juridik, për regjistrimin e armëve të koleksionit ose muzeut, që nuk janë paaftësuar/çaktivizuar, pajiset me autorizim për koleksionim armësh nga komisioni qendror i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi ka plotësuar të gjitha kriteret e neneve 34 e 35, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, si dhe kushtet e sigurisë së objektit, kriteret e sigurisë së armëve në vendin e koleksionimit ose muzeut, sipas përcaktimit të akteve nënligjore.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1 Për armët e koleksionit të deklaruara “pasuri kulturore”, të cilat janë të vjedhura ose të humbura, bëhet regjistrimi edhe në bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, sipas procedurave dhe mënyrave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.”.

4. Në pikën 4, pas fjalës “... paraqet ...” shtohet fjala “... *online*, në portalin unik qeveritar, *e-Albania*.”.

5. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Personi fizik dhe juridik, për të marrë autorizimin si koleksionist ose person i autorizuar për administrimin e armëve në muze, paraqet kërkesën përmes platformës *online*, dokumentacionin dhe listën me armët që zotëron, pranë IKRTK-së, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.”.

6. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Armët e koleksionit dhe armët e koleksionit të deklaruara pasuri kulturore u nënshtrohen parashikimeve të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore, në përputhje me rregullat e ndryshimit të pronësisë së armëve, sa u përket mbajtjes, mbrojtjes, vlerësimit, administrimit dhe tjetërsimit të pronësisë së tyre.”.

7. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1 Për armët e koleksionit të deklaruara pasuri kulturore, importi ose eksporti i tyre kryhet përmes lëshimit të licencave të import/eksportit të pasurive kulturore.

Shitblerja e armëve të koleksionit të deklaruara pasuri kulturore i nënshtrohet procedurave të parashikuara në vendimin nr. 199, datë 31.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shqyrtimin ose anulimin e licencës, tarifat e kërkesës dhe



kuotizacionin vjetor të licencave për veprimtari tregtare të pasurive kulturore”.”.

8. Në pikën 11, pas fjalisë së parë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Për armët e koleksionit të deklaruar pasuri kulturore lëvizja dhe transportimi bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.”.

9. Në pikën 12, pas fjalisë së parë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Për armët e koleksionit të deklaruar pasuri kulturore kërkohet autorizimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.”.

10. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Çaktivizimi/paafësimi i armëve të koleksionit kryhet me të njëjtën procedurë dhe të njëjtat kritere si edhe për armët e tjera. Çaktivizimi/paafësimi bëhet nga persona fizikë ose juridikë, të pajisur me licencë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për çaktivizimin/paafësimin e armëve të zjarrit për përdorim civil.”.

II. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 271, datë 12.5.2021

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 275, DATË 1.4.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR
KUSHTET DHE RREGULLAT E
SIGURISË SË ARMËVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 3, 17, pika 4 dhe 28, pika 4, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 275, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, të nenit 1, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën “b”, pas fjalës “... pjesëve...” shtohet “... kryesore...”.

b) Në shkronjën “c”, pas fjalës “... armëve ...” shtohen fjalët “... pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre ...”.

c) Në shkronjën “ç”, pas fjalës “... civil ...” shtohen fjalët “... të hapur, të mbyllur dhe me pjatel ...”.

2. Në nenin 5 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë si vijon:

“Kushtet e përgjithshme për ruajtjen e armëve të zjarrit, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre bazohen e variojnë sipas numrit të armëve të zjarrit të lejuara për mbajtje, pjesëve kryesore dhe sasisë së municioneve të tyre, sipas kësaj ndarjeje.”.

b) Në shkronjën “d”, pas fjalëve “... tregtimin e armëve ...” shtohen “... pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre të kategorisë “C” dhe “D”.”.

3. Neni 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 11

Transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre mund ta bëjë çdo person fizik dhe juridik me seli në Republikën e Shqipërisë, që është licencuar nga Policia e Shtetit për këtë qëllim.”.

4. Paragrafi i parë, i nenit 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Subjektet e licencuara për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre duhet të plotësojnë këto kushte:...”.

5. Në nenin 15 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Kudo në tekstin e nenit, pas fjalës “... poligon ...” shtohet fjala “... civil ...”.

b) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) poligon civil qitjeje me pjatel.”.

c) Pas pikës b.1 shtohet pika c.1 me këtë përmbajtje:



“c.1. Poligon civil qitjeje me pjatel është pjesë terreni (territori) e përzgjedhur dhe e përgatitur sipas kritereve standarde për zhvillimin e qitjeve me armët e gjahut.”.

6. Në nenin 16 shtohen shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, me këtë përmbajtje:

“d) Ambienti të jetë me kushte të tilla që të garantojë që predhat/saçmat të mos bien në lumenj, rezervate apo liqene;

dh) Të respektojë standardet për mbrojtjen nga ndotja akustike;

e) Të disponohet leje nga autoriteti shtetëror përkatës ku do të ndërtohet poligoni civil i hapur.”.

7. Pas nenit 16 shtohet neni 16/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 16/1

Rregullat e ndërtimit dhe shfrytëzimit të poligonit civil me pjatel

Poligoni civil i ndërtuar në natyrë duhet të plotësojë këto kushte:

a) Të jetë larg qendrave të banuara dhe drejtimi i qitjes me pjatel të jetë në drejtim të kundërt me banesat;

b) Në drejtim të qitjes, poligoni sigurohet në më shumë se 200 m në vijë ajrore dhe 100 m në të dyja krahët në këndin 90 gradë me drejtimin e qitjes;

c) Ambienti të jetë me kushte të tilla që të garantojë që saçmat të mos bien në lumenj, rezervate apo liqene;

ç) Të respektojë standardet për mbrojtjen nga ndotja akustike;

d) Të disponohet leje nga autoriteti shtetëror përkatës, ku do të ndërtohet poligoni me pjatel;

dh) Të ketë kushte të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve që krijohen gjatë qitjes apo gjatë shërbimeve të tjera që ofrohen në poligon, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.”.

8. Në nenin 17 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Ndarjet e ambienteve në poligonet e qitjes.

Çdo poligon civil ka:

i. dhomën e regjistrimit të mbrojtur me xham antiplumb;

ii. dhomën e komandës nga e cila monitorohen veprimet gjatë zhvillimit të qitjes;

iii. dy ose më shumë korsi të qitjes.”.

b) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Lartësia e poligonit: jo më pak se 280 cm;”.

9. Në nenin 23 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë dhe shkronja “a” e nenit 23 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Objekti që shërben për tregtimin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre nga brenda duhet të pajiset me:

a) kasaforta të sigurt sipas sasisë së armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, si në rastet e përcaktuara në këtë rregullore për armët e zjarrit.”.

b) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) të ketë kushte të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve që krijohen gjatë shërbimeve që ofrohen në objekt, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.”.

II. Ngarkohet Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, të kërkojë e të mbikëqyrë zbatimin e rregullave e të procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe



VENDIM

Nr. 272, datë 12.5.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 348, DATË 29.4.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PROCEDURAT E HYRJES/DALJES,
VULOSJES SË ARMËVE DHE
REGJISTRIMIT TË SHTETASVE
SHQIPTARË E TË HUAJ ME ARMË TË
KATEGORISË “B” DHE “C” NË
TERRITORIN E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 7, të nenit 9, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 348, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I, “Regjimi për hyrje/daljet dhe regjistrimin e armëve në territorin e Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronjat “a”, “c”, dhe “ç”, të pikës 2, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Licencë për import dhe tregtim të armëve të kategorive “C” (gjahut), pjesëve kryesore dhe municionit të tyre të lëshuar nga Komisioni Qendror në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ose licencë për import/eksport, ndërmjetësim, tranzit, për armët e kategorive “B”, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre të lëshuar nga struktura përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

c) Licencë të lëshuar nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, për import/eksport të armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre.

ç) Dokumentin e blerjes së armëve, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre. Armët regjistrohen me numra serialë, numrat serialë të pjesëve kryesore, tipin, kalibrin, modelin shtetin prodhues dhe fabrikën e prodhimit.”

b) Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. Në rastet kur punonjësi i policisë kufitare, gjatë kontrollit fizik, gjen armë, pjesë të armëve dhe municion, të cilat subjekti i licencuar, person fizik ose juridik, nuk i ka në inventarin shoqërues

autorizimit të importit ose ato janë armë dhe municione që nuk përfshihen në autorizimin e importit ose kanë numra të ndryshëm serialë nga ato në autorizim, punonjësi i policisë/doganës duhet të sekuestrojë armën dhe municionin. Ai njofton vendin e eksportit/importit që të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të ndryshojë autorizimin, duke përditësuar inventarin shoqërues ose të tërheqë armën, pjesën e armës ose municionin që nuk është në inventarin fizik shoqërues, pas kryerjes së veprimeve procedurale penale në shtetin e origjinës ose shtetet ku kanë kaluar tranzit. Armët, pjesët e armëve dhe municionet, të cilat nga kontrolli fizik rezultojnë se nuk kanë një numër serial, sekuestrohen nga autoritetet pas kryerjes së veprimeve procedurale penale të nevojshme nga punonjësi i policisë kufitare dhe tërhiqen më pas nga vendi i eksportit.”

2. Titulli i kreut të dytë ndryshohet dhe bëhet “Procedurat e markimit të armëve të zjarrit”.

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Për kategorinë “B” dhe “C” të armëve dhe pjesët kryesore të tyre, të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë duhet të kenë të shënuar një markim të dukshëm, të përhershëm dhe unik. Markimi unik përfshin emrin e prodhuesit ose markën, shtetin ose vendin e prodhimit, numrin e serisë, vitin e prodhimit dhe modelin nëse nuk është pjesë e numrit të serisë. Markimi është detyrim i subjektit të licencuar për import/eksport të armëve të zjarrit, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.”

4. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1 Municionet e prodhuara dhe të importuara duhet të përmbajnë markimin e plotë në çdo pako (paketim), në mënyrë që të tregojë vendin e prodhimit, emrin e prodhuesit, numrin e identifikimit të partisë (lotit), vitin e prodhimit, kalibrin dhe llojin e municioneve.”

5. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Markimi i armëve të zjarrit të kategorive “B” dhe “C” bëhet për armët e importuara nga të gjitha vendet me destinacion Shqipërinë, pavarësisht shënimit që kanë nga vendet e origjinës. Përfshihen nga kjo procedurë armët e importuara nga vendet e BE-së, mbi të cilat një shtet anëtar ka vendosur një markim.”

6. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“11. Markimi i armëve të zjarrit realizohet nëpërmjet shtypjes me shkronja e numra. Marka e Shqipërisë shënohet AL në një rreth me diametër 6 mm. Viti i importimit shënohet jashtë rrethit me madhësi 3 mm. Thellësia minimale e brazdës bëhet me të paktën 0,1 mm, nëse vendoset në një pjesë metalike, dhe të paktën 0,3 mm nëse realizohet në një pjesë polimer.”.

7. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Markimi vendoset në pjesën kryesore të dukshme të armës së zjarrit dhe në pjesët kryesore të armëve. Markimi duhet të jetë i pazëvendësueshëm në asnjë rrethanë.”.

8. Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Subjektet e licencuara sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, janë përgjegjëse për markimin e armëve të zjarrit të kategorisë “B”, të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë. Markimi i armëve të kategorisë “B” dhe pjesët kryesore realizohet në vendin e origjinës nga ku importohen dhe duhet të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara, sipas pikave 11 dhe 12, të këtij vendimi. Standardet e përcaktuara sipas pikave 11 dhe 12, të këtij vendimi, kontrollohen në pikën e kalimit kufitar nga Policia e Shtetit. Armët që nuk përmbushin standardet e markimit sekuestrohen.”.

9. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Procedurat e markimit nuk aplikohen:

a) për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre të importuara nga vendet e BE-së, nëse nga shteti eksportues janë markuar;

b) për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre, të cilat importohen ekskluzivisht për qëllime kërkimore. Në këtë rast armët markohen me inicialet “LB”;

c) për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre, të cilat lëvizin tranzit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë;

ç) për armët e zjarrit të cilat janë pjesë e trashëgimisë kulturore (armë zjarri antike).”.

10. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Procedurave të markimit u nënshtrohen edhe armët e zjarrit që çaktivizohen. Markimi i armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre bëhet nga subjekte shtetërore të licencuara për çaktivizimin e armëve të zjarrit. Modeli i markimit unik të çaktivizimit është: EU(1) Aa(2) bb(3) c(4).

(1): Vendoset në fillim të markimit për të gjitha vendet e BE-së;

(2): Shteti që kryen çaktivizimin;

(3): Simboli i strukturës që kryen çaktivizimin;

(4): Viti kur është kryer çaktivizimi.”.

11. Pika 16 shfuqizohet.

12. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Armët e zjarrit të markuara sipas procedurave të pikës 15, të këtij vendimi, para se të jepen për përdorim kontrollohen nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit. Për të gjitha armët jepen certifikatat e markimit. Nuk lejohet të jepen për përdorim armët e zjarrit të pamarkuara.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 273, datë 12.5.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1088, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE TË PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT DHE PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE PËR PRONARËT PËRFITUES, SI DHE TË NJOFTIMIT NGA AUTORITETET SHTETËRORE KOMPETENTE DHE NGA SUBJEKTET E DETYRUARA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, 6, pikat 8, 9, e 10, dhe 15, pika 4, të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1088, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut I, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) “Kërkesa” është aplikimi që i drejtohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për kryerjen e veprimeve në regjistrë, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.”.



2. Kudo në vendim, fjala “... Aplikim ...” zëvendësohet me “... Kërkesë ...”.

3. Pika 9, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Procedura e regjistrimit fillestar nga subjektet raportuese ekzistuese të të dhënave për pronarët e tyre përfitues realizohet sipas parashikimeve të këtij kreu dhe sipas pikës 3, të nenit 15, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues. Subjektet raportuese ekzistuese, të cilat rezultojnë me status të pezulluar në regjistrin tregtar, regjistrojnë pronarin përfitues në regjistrin e pronarit përfitues, përpara kërkesës për ndryshimin e statusit të tyre në regjistrin tregtar. Ndryshimi i statusit të subjekteve raportuese ekzistuese në regjistrin tregtar kryhet pas verifikimit se është regjistruar pronari përfitues i tyre, në regjistrin e pronarëve përfitues.”.

4. Shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të kreut III, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“c) Dokumentacioni i përcaktuar në nënndarjet “i” dhe “iii”, të shkronjës “a”, të kësaj pike, duhet të jetë hartuar brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e regjistrimit fillestar të subjekteve raportuese në regjistrat përkatës.

ç) Dokumentacioni i përcaktuar në nënndarjet “i” dhe “iii”, të shkronjës “b”, të kësaj pike, duhet të jetë hartuar brenda të njëjtit afat të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 3, të nenit 5, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 274, datë 12.5.2021

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE QË DUHET TË PËRMBUSHË ORGANIZATA KOMBËTARE PËRFAQËSUESE RINORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore (në vijim OKPR-ja) të themelohet nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse, dhe të përfaqësojë nevojat dhe interesat e të rinjve pranë grupeve të interesit, duke nxitur gjithëpërfshirjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes.

2. OKPR-ja, që njihet si e tillë nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, duhet të përmbushë këto kritere:

a) të jetë e themeluar dhe e regjistruar në gjykatën kompetente në formën e një shoqate me anëtarësi nga organizata rinore dhe/ose për të rinjtë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;

b) të ketë statut të miratuar nga gjykata kompetente;

c) të ketë një anëtarësi prej jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) organizatash rinore dhe/ose për të rinjtë, të cilat duhet:

i. të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitete dhe veprimtari rinore;

ii. të kenë shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

iii. të kenë përvojë në aktivitetet dhe veprimtaritë rinore;

iv. të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

v. të mos jenë të dënuar, organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

vi. të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në 12 (dymbëdhjetë) qarqet e Republikës së Shqipërisë, sipas ndarjes territoriale;

vii. të kenë diversitet në fushat e veprimtarisë rinore ose për të rinjtë në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

3. Të drejtën për të kërkuar njohjen si OKPR e kanë organizatat, të cilat plotësojnë kriteret e këtij vendimi dhe përparësi kanë organizatat, anëtarët themelues të të cilave kanë eksperiencë më të gjatë, numrin më të lartë të anëtarësisë së organizatave rinore, mbulojnë me veprimtari pjesën më të madhe të territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë bashkëpunime me organizata me status të



ngjashëm që veprojnë në vendet e Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, si dhe në rast se 70% e organizatave të anëtarësuara janë organizata rinore.

4. Dokumentacioni, që duhet të depozitohet nga organizata jofitimprurëse pranë Agjencisë Kombëtare të Rinisë për t'u njohur si OKPR, përmban:

- a) aktin e regjistrimit në gjykatë;
- b) kopjen e statutit të saj;
- c) kopje të statuteve të organizatave themeluese të OKPR-së, ku specifikohen si pjesë e veprimtarisë së tyre aktivitete dhe veprimtari rinore;
- ç) vërtetimet nga organet tatimore që organizatat themeluese të OKPR-së i kanë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;
- d) vërtetimet nga gjykata se organizatat themeluese të OKPR-së nuk janë në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;
- dh) vërtetime nga gjykata se organizatat themeluese të OKPR-së dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 275, datë 12.5.2021

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR
MARRJEN E MOSTRAVE DHE
KRYERJEN E ANALIZAVE
LABORATORIKE TË NEVOJSHME PËR
KONTROLLIN E KRIPËS SË JODIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 9942, datë 26.6.2008, "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifa për marrjen e mostrave për përcaktimin e nivelit të jodit në kripën ushqimore
Faqe | 8156

të jodizuar është 8 500 (tetë mijë e pesëqind) lekë.

2. Tarifa për kryerjen e analizave laboratorike për përcaktimin e nivelit të jodit në kripën ushqimore të jodizuar është 4 000 (katër mijë) lekë.

3. Tarifa, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përfshin koston e transportit dhe koston e analizimit të mostrës së kripës ushqimore të jodizuar në laboratorët e brendshëm të saj, kur marrja e mostrës së kripës ushqimore të jodizuar, sipas procedurës realizohet nga struktura rajonale e shëndetësisë në pikën e prodhimit apo në pikat doganore (degët doganore kufitare).

4. Tarifa, në rast kërkesë për përsëritje të analizës laboratorike nga subjektet prodhuese ose importuese, është e njëjtë me vlerën e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 277, datë 12.5.2021

**PËR DHËNIEN E STATUSIT TË
VEÇANTË "INVESTITOR NË
STRUKTURË AKOMODUESE ME 5 YJE,
STATUS SPECIAL", APLIKUESIT
"MARINA AL" SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33/1, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e statusit të veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special", aplikuesit "Marina AL" sh.p.k.

2. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM

Nr. 278, datë 12.5.2021

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE
MJEDISIT, PËR MBËSHTETJEN E
TURIZMIT SHQIPTAR PËR
PROMOVIMIN NË TREGJET
NDËRKOMBËTARE POST COVID-19**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në programin “Zhvillimi i turizmit”, në artikullin 602 (shpenzime operative), për Agjencinë Kombëtare të Turizmit, i shtohet fondi prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për mbështetjen e turizmit shqiptar për promovimin në tregjet ndërkombëtare post COVID-19 dhe prezantimin e Shqipërisë si një destinacion mikpritës COVID-free.

2. Efekti financiar, prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 279, datë 12.5.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT SOCIAL-
KULTUROR, PALLATI I KULTURËS,
BASHKIA SHIJAK, DHE CAKTIMIN E
BASHKISË SHIJAK SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 190 601 138 (njëqind e nëntëdhjetë milionë e gjashtëqind e një mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.

2. Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 38 120 227 (tridhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzet mijë e dyqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin e Bashkisë Shijak si njësi zbatuese për rindërtimin e objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM

Nr. 280, datë 12.5.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
PËRGATITJES SË SHESHEVE TË
NDËRTIMIT, NË BASHKINË MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 43 687 591 (dyzet e tre milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një) lekësh, për financimin e prishjes së njësisë individuale të banimit, në Bashkinë Mirditë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Mirditë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 281, datë 12.5.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT DHE TË
RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË
BASHKËPRONËSI OSE TË
PËRBASHKËTA NË NDËRTESA
(PALLAT), NË BASHKINË MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 326 012 468 (treqind e njëzet e gjashtë milionë e dymbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë.

2. Fondi financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t’i transferohet Bashkisë Mirditë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

**VENDIM**

Nr. 282, datë 12.5.2021

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1047, DATË 16.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE ‘AT ZEF PËLLUMBI’, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNGJIN, BASHKIA LEZHË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 2, të vendimit nr. 1047, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Përdorimi i fondit për vitin 2021 të jetë në masën 181 200 000 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e dyqind mijë) lekë pa TVSH dhe i transferohet Bashkisë Lezhë për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “At Zef Pëllumbi”, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 283, datë 12.5.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 26, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË DHE ÇAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në bashkitë Kamzë dhe Kavajë, në masën 619 885 285 (gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit dhe detajohet, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 150 886 168 (njëqind e pesëdhjetë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi në masën 468 999 117 (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.



2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë e Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë